

Përmbledhje

Ekonomia e Kosovës gjatë TM2 2014 u karakterizua me përshpejtim të aktivitetit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sidoqoftë, në bazë sektoriale, gjatë kësaj periudhe kishte ngecje që erdhën nga sektori i jashtëm si rezultat i thellimit të deficitit tregtar. Zhvillimet negative nga sektori i jashtëm u neutralizuan deri një masë nga zgjerimi më i theksuar i aktivitetit kreditor të sektorit bankar.

Sektori fiskal, përkundër se u karakterizua me rritje të shpenzimeve, ndryshoi strukturën duke rritur shpenzimet rrjedhëse, ndërsa shpenzimet kapitale gjatë kësaj periudhe shënuan rënie të kosniderueshme. Në anën tjetër, të hyrat buxhetore gjatë TM2 2014 vazhduan të karakterizohen me norma pozitive të rritjes.

Ndërmjetësimi financiar gjatë TM2 2014 ka përshpejtuar trendet pozitive duke u karakterizuar me rritje vjetore të kredive prej 3.5 përqind. Ky përshpejtim i rritjes erdhi pas një periudhe prej më shumë se 12 muaj ku kreditimi u karakterizua me rritje më të ulët se 3 përqind. Në anën tjetër, rritja e depozitave prej 10.0 përqind rikthehet pas një periudhe më të gjatë se 2 vjeçare. Sektori bankar ka vazhduar të zvogëlojë normat e interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Mesatarja e normës së interesit në kredi gjatë TM2 2014 ishte 10.6 përqind, ndërsa mestarja e interesit në depozita ishte 0.6 përqind.

Si rezultat i rritjes më të shpejtë të depozitave në krahasim me kreditë, raporti kredi-depozita në fund të qershorit 2014 ishte më i ulët krahasuar me TM2 2013.

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe njëkohësisht vërehet rënie e normës së kredive joperformuese nga 8.6 përqind sa ishin në mars 2014 në 8.2 përqind në qershor 2014 (7.8 përqind në qershor 2013). Sektori bankar vazhdon të ketë pozitë të kënaqshme edhe për sa i përket nivelit të kapitalizimit dhe të likuiditetit.

Sektori i jashtëm në gjysmën e parë të vitit 2014 është karakterizuar me trende negative në disa tregues. Deficiti tregtar i mallrave është përkeqësuar si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve. Sa i përket komponentave tjera të bilancit të pagesave, IHD-të kanë shënuar rënie në TM1 2014 krahasuar me TM1 2013, ndërsa, rritja e remittanceve si dhe rritja e eksportit të shërbimeve ka ndikuar në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Inflacioni është karakterizuar me rënie të theksuar. Në TM2 2014, norma e inflacionit ishte 0.4 përqind krahasuar me normën prej 2.4 përqind në TM2 2013. Niveli i inflacionit në Kosovë vazhdon që në masë të madhe të reflektojë lëvizjen e çmimeve të importit, të cilat më së shumti reflektohen në vend nëpërmjet çmimeve të produkteve ushqimore por edhe çmimeve të naftës.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Ekonomia globale	04
Ekonomia e Kosovës	07
Sektori Real	07
Sektori Fiskal	09
Sistemi Financiar	10
Sektori Bankar	11
Fondet Pensionale	18
Kompanitë e Sigurimit	18
Institucionet Mikrofinanciare	18
Tregu i Bonove të Thesarit	20
Sektori i Jashtëm	21
GRAFIKËT DHE TABELAT	05
Figura 1. Norma e kreditimit ndër bankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	05
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	05
Figura 3. Çmimi i arit për ounce	06
Figura 4. Çmimet e metaleve	06
Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 6. Norma e këmbimit e euros	07
Figura 7. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 8. Norma e inflacionit sipas tremujorëve	08
Figura 9. Indeksi i çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	08
Figura 10. Regjistri i bizneseve	09
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 12. Asetet e sistemit financiar në Kosovë	10
Figura 13. Asetet e bankave komerciale	11
Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	11
Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	12
Figura 16. Kreditë sipas sektorëve të veçantë ekonomik	12
Figura 17. Struktura e maturimit të kredive	13
Figura 18. Struktura e maturimit të kredive të reja	13

Figura 19. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale-----	13
Figura 20. Struktura e depozitave në bankat komerciale -----	14
Figura 21. Mesatarja e normave të interesit-----	14
Figura 22. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve-----	14
Figura 23. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare-----	15
Figura 24. Normat mesatare të interesit për depozita -----	15
Figura 25. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale -----	16
Figura 26. Treguesit e profitabilitetit-----	17
Figura 27. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë-----	17
Figura 28. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese -----	17
Figura 29. Asetet e institucioneve mikrofinanciare -----	19
Figura 30. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë -----	20
Figura 31. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	21
Figura 32. Remitencat -----	21
Figura 33. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve -----	22
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	24

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërformuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Ekonomia Globale

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është karakterizuar me zhvillime më të favorshme në krahasim me vitin 2013. Megjithatë, si rezultat i aktivitetit më të dobët ekonomik në SHBA dhe në disa nga vendet në zhvillim, në korrik 2014, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka reviduar projeksionet për rritjen globale ekonomike në 3.4 përqind, nga 3.6 përqind sa ishin projeksionet e prillit 2014. Marrë parasysh se të dhënat e publikuara në tremujorin e dytë treguan për aktivitet më të dobët se që është pritur në disa nga ekonomitë kryesore, sidomos në Eurozonë, projeksionet ekonomike mund të jenë subjekt i revidimeve të mëtejme. Për vitin 2015, projeksionet sugjerojnë rritje prej 4 përqind në nivel global, që do të nënkuptonte rikuperim të konsiderueshëm të ekonomisë globale (IMF WOE, 2014).

Ekonomia e Eurozonës në vitin 2014 pritet shënojë rritje, por se zhvillimet në TM2 2014 në dy ekonomitë kryesore të sajë, Franca dhe Gjermania, u karakterizuan me aktivitet më të dobët se që është pritur. Në TM2 2014, Gjermania u karakterizua me rënie për herë të parë që nga viti 2012, që u nxit nga kriza ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë. Kjo pasi që mosmarrëveshjet ndërmjet vendeve perëndimore dhe Rusisë u përcollën edhe me sanksione të dyanshme, gjë që ka ndikuar në rënie të theksuar të eksporteve të Gjermanisë në Rusi. Vështirësi të ngjashme kanë karakterizuar edhe ekonominë e Francës, ku të dhënat tregojnë për stagnim të prodhimit. Sidoqoftë,


projeksionet për rritjen ekonomike në të dy këto vende vazhdojnë të jenë pozitive për vitin 2014.

Në nivel global, norma e inflacionit gjatë vitit 2014 pritet të jetë 3.5 përqind, krahasuar me 3.6 përqind sa ishte në vitin paraprak. Sipas Bankës Qendrore Evropiane, inflacioni në eurozonë në TM2 2014 zbriti në 0.6 përqind, nga 0.7 përqind në TM1 2014. Për vitin 2014, projeksionet për normën e inflacionit në Eurozonë janë reviduar nga 1.5 në 1 përqind si rezultat i çmimeve më të ulëta gjatë gjysmës së parë të vitit, por edhe i zhvillimeve më të ngadalshme në kërkesën e brendshme dhe mungesën e kreditimit ndërbankar, sidomos në zonat periferike të Eurozonës. Ky nivel i inflacionit në Eurozonë vazhdon të jetë në cakun prej 2 përqind, të përcaktuar nga Bankave Qendrore Evropiane (BQE), gjë që ka rritur domosdoshmërinë e masave për të rikthyer inflacionin më afër caktut. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, në javën e parë të qershorit 2014, BQE zvogëloi edhe më tutje normën bazë të rifinancimit, duke e zbritur në nivelin më të ulët historik prej 0.15 përqind. Ndryshimi i normës bazë të rifinancimit është bërë me qëllim që të nxisë rritjen e kreditimit dhe, rrjedhimisht, të stimulojë aktivitetin ekonomik. Normat më të ulëta të interesit pritet të ndikojnë edhe në evitimin e vlerësimit të mundshëm të valutës euro kundrejt valutave tjera, duke ndikuar kështu në rritjen e konkurrueshmërisë së eksporteve të Eurozonës.

Përkundër zvogëlimit të normës bazë të rifinancimit nga BQE, normat e interesit të kreditimit ndërbankar Euribor u karakterizuan me rritje të normave 1 mujore në mesatarisht 0.15 përqind në TM2 2014 nga

0.12 përqind në TM2 2013. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore mbetën të pandryshuara nga periudha e njëjtë e vitit paraprak në 0.51 në TM2 2014. Rritja e normës së interesit të kreditimit ndërbankar gjatë kësaj periudhe i adresohet vazhdimit të hezitimit të bankave nga vendet kryesore të eurozonës për të kredituar bankat në vendet periferike.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së




Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

Rajoni i Evropës Juglindore (EJL) në përgjithësi është vlerësuar të jetë ballafaquar me përkeqësim të aktivitetit ekonomik në TM1 2014 krahasuar me TM1 2013. Në anën tjetër, projeksionet për vitin 2014 në përgjithësi sugjerojnë një rritje të lehtë të aktivitetit ekonomik, me përjashtim të Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat pritet të kenë rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Projeksionet për vitin 2014 sugjerojnë normë mesatare të rritjes së PBB-së prej rreth 2.1 përqind për vendet e EJL-së krahasuar me normën prej 1.7 përqind në vitin paraprak. Kosova pritet të ketë rritjen më të lartë vjetore të PBB-së, pasuar nga Maqedonia e cila pritet të arrijë normën prej 3.2 përqind, pastaj Mali i Zi prej 2.8 përqind, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina pritet të shënojnë

normë të ngjashme të rritjes prej 2.0 përqind, si dhe Serbia 1.0 përqind rritje të PBB-së. Kroacia mbetet vendi i vetëm në rajon që pritet të karakterizohet me rënie ekonomike (0.6 përqind për vitin 2014) për të pestin vit me radhë. Ngjashëm me vendet e eurozonës, inflacioni në vendet e EJL-së gjatë vitit 2014 pritet të jetë 1.9 përqind nga 2.7 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Çmimet e naftës (brent crud)¹ në TM2 2014 shënuan rritje për rreth 8.6 përqind krahasuar me TM2 2013.

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: IMF (2014) dhe kalkulimet e BQK-së


Pritjet aktuale janë se çmimet e naftës do të jenë relativisht stabile gjatë vitit 2014, por se ekzistojnë rreziqe për zvogëlim të ofertës dhe rrjedhimisht rritje të çmimeve, si rezultat i konflikteve në dy vende të Lindjes së Mesme që kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në tregjet globale.

Çmimet mesatare të arit gjatë TM2 2014 kanë shënuar rënie prej rreth 8.9 përqind në krahasim me TM2 2013, por se në krahasim me TM1 2014, rënia në çmime ka qenë më e ulët. Projeksionet sugjerojnë se çmimi i arit do të vazhdojë të shënojë rënie të lehtë

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

gjatë gjithë vitit 2014, gjë që ndërlihet edhe me stabilitetin e valutave kryesore e cila zvogëlon kërkesën për ari (FMN, 2014).


Figura 3. Çmimi i arit për ounce



Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

Metalet tjera, me përjashtim të zinkut, kanë shënuar rënie vjetore të çmimeve. Në TM2 2014, krahasuar me TM2 2013, çmimet e aluminit kanë shënuar rënie vjetore prej 6.5 përqind. Këto lëvizje në çmimet e aluminit janë diktuar kryesisht si rezultat i ofertës së lartë në nivel global. Çmimi i plumbit ka shënuar rënie prej rreth 2.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 4).

Figura 4. Çmimet e metaleve, në USD për ton




Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

Metalet e zinkut janë karakterizuar me rritje të çmimit në TM2 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 6.7 përqind duke arritur nivelin më të lartë të çmimit që nga viti 2012. Vlen të theksohet se edhe çmimi i aluminit në TM2 2014 është rikuperuar për 5 përqind krahasuar me TM1 2014. Projektionet e fundit të FMN-së sugjerojnë për mos ndryshime të mëtejme të çmimeve të metaleve gjatë vitit 2014.

Mallrat ushqimore në nivel global gjatë TM2 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve kundrejt TM2 2013. Rënia e çmimeve të drithërave gjatë TM2 2014 kundrejt TM2 2013 ishte rreth 15.6 përqind, përderisa indeksi i përgjithshëm i mallrave ushqimore ishte më i ulët për rreth 2.8 përqind.


Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAOUN (2014)

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë TM2 2014 ka pasur lëvizje të lehta. Euro ndaj sterlinës britanike ka shënuar rënie për 2.7 përqind; ndaj frankës zvicerane ka shënuar rënie për 0.2 përqind; ndërsa, është përforcuar ndaj dollarit amerikan për 0.1 përqind.

Figura 6. Norma e këmbimit e Euros



Burimi: BQK (2014)


Rritja ekonomike globale pritet të përforcohet gjatë vitit 2014, megjithëse me ritëm më të ngadalshëm se që ishte pritur fillimisht. Në eurozonë, të dhënat për tremujorin e dytë tregojnë për përkeqësime të papritura, sidomos në Gjermani; Rreziqet gjeopolitike vazhdojnë të paraqesin shqetësim, sidomos për çmimet e naftës.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Norma e rritjes ekonomike për vitin 2013, sipas BQK-së, vlerësohet të ketë qenë rreth 3.1 përqind (figura 7), ndërsa për vitin 2014 pritet përshpejtim i rritjes së aktivitetit ekonomik². Ky shtim i aktivitetit ekonomik pritet të gjenerohet nga rritja e konsumit, përderisa investimet pritet të shënojnë rënie të lehtë. Po ashtu, edhe eksporti neto pritet të rrisë deficitin, kryesisht për shkak të rritjes së importit të mallrave.

Figura 7. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



Burimi: ASK (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për vitin 2013 (2014)


Të dhënat deri në qershor 2014 paraqesin një rritje më të lartë të konsumit, i cili është ndikuar nga rritja e pagave dhe mëditjeve të sektorit publik, pastaj subvencioneve dhe transfereve, e në masë më të vogël mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, remitencat të cilat në TM1 2014 kanë pasur performancë të mirë si rezultat i rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara, kanë përkrahur rritjen e konsumit. Në anën tjetër, investimet publike deri në qershor 2014 kanë shënuar rënie të konsiderueshme, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte kanë shënuar rënie në

² Projektionet makroekonomike për vitin 2014 do të publikohen në numrin e ardhshëm të Raportit të Zhvillimeve Makroekonomike.

TM1 2014. Përkundër rënies së investimeve publike dhe IHD-ve, aktiviteti i sektorit privat është përkrahur nga kreditë e sistemit bankar të cilat vazhduan të rriten.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), deri në qershor 2014 u karakterizua me rënie të theksuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Norma mesatare tremujore e inflacionit në TM2 2014 ishte 0.4 përqind krahasuar me mesataren prej 2.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. (figura 8).

Figura 8. Norma e inflacionit sipas tremujorëve




Burimi: ASK (2014)

Sa i përket komponentëve të CPI-së, rritje e çmimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 u shënuar kryesisht tek pijet alkoolike dhe duhani me 4.8 përqind, veshmbathja me 3.3 përqind, restaurantet dhe hotelet me 2.4 përqind, strehimi, uji, rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse me 2.3 përqind. Ndërsa, rënie e çmimeve kryesisht u evidentua tek shërbimet e transportit me -1.5 përqind, ushqimi dhe pijet joalkoolike me -1.2 përqind. Ushqimi i cili përbën rreth 37.8 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, paraqet kategorinë kryesore që është duke shkaktuar rënien e inflacionit.

Në kuadër të ushqimit, vajrat dhe yndyrat shënuan rënie prej 11.4 përqind në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014, pasur nga buka dhe drithërat me 5.5 përqind, sheqeri dhe ëmbëlsirat e ndryshme me 5.1 përqind dhe perimet me 3.5 përqind, ndërsa kategoritë kryesore që shënuan rritje të çmimeve në kuadër të ushqimit ishin pemët me 3.6 përqind dhe mishin me 3.4 përqind.

Figura 9. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2014)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është mjaft e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në nivel global si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet (figura 9). Që nga viti i kaluar, indeksi i çmimeve të importit (angl: Import Price Index: IPI) është duke shënuar rënie. Në TM1 2014, IPI ka shënuar rënie për 0.9 përqind, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të tekstilit, artikujve ushqimor, dhe pajisjeve elektrike. Sjellje të ngjashme gjatë TM1 2014 kanë pasur edhe çmimet e prodhimit, indeksi i të cilave shënoi rënie vjetore prej 1.0 përqind, rënie kjo e cila u nxit nga rënia e çmimeve të prodhimit të metaleve dhe nxjerrjes së mineraleve metalike.

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, gjatë TM1 2014, në Kosovë u regjistruan 2,912 ndërmarrje të

reja apo 189 ndërmarrje më pak se sa në TM1 2013, ndërsa u mbyllën 436 biznese apo 29 biznese më shumë se sa në TM1 2013 (figura 10).


Figura 10. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2014)

Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar, por se ky vit është karakterizuar me rritje të numrit të bizneseve të reja në tregti, hotele dhe restorante, dhe transport dhe telekomunikacion, ndërsa bujqësia, industria përpunuese dhe ndërtimtaria kanë shënuar rënie krahasuar me TM1 2013 (figura 11).

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2014)

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore neto deri në qershor 2014 shënuan rënie të lehtë vjetore prej 0.3 përqind duke arritur në 603.0 milionë euro. Kjo rënie e të hyrave buxhetore është kryesisht për shkak se në vitin 2014 nuk janë arkëtuar të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin realizuar 30.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda e realizuar në vitin 2013, atëherë të hyrat buxhetore deri në qershor 2014 shënuan rritje prej 4.9 përqind. Shpenzimet buxhetore deri në qershor 2014 arritën vlerën prej 625.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 2.1 përqind. Rrjedhimisht, në gjashtë muajt e parë të vitit 2014, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 22.0 milionë euro krahasuar me deficitin prej 7.6 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ekzekutimi i shpenzimeve të planifikuara deri në qershor 2014 ishte pothuajse i njëjtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (38.7 përqind e planit vjetor), ndërkohë që realizimi i të hyrave buxhetore ishte për 1.7 pikë përqindje më i ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit të paraprak (41.4 përqind e planit për vitin 2014).

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura në kufi të cilat shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind dhe kanë arritur nivelin bruto prej 383.0 milionë euro. Rritja e të hyrave të mbledhura në kufi, deri në një masë, reflekton rritjen e kontroleve në të gjitha pikëkalimet kufitare, përmirësimin e kualitetit të vlerësimit të mallrave me rastin e zhdoganimit të tyre


si dhe rritjen e importit të mallrave. Të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore kishin performancë të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën bruto prej 148.0 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 23.0 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 4.0 përqind. Gjithashtu, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rritje për 8.5 përqind duke arritur vlerën prej 51.0 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 të gjitha kategoritë shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, me përjashtim të shpenzimeve kapitale të cilat shënuan rënie. Investimet kapitale, që në gjysmën e parë të vitit 2014 përfaqësuan rreth 21.9 përqind të gjithsej shpenzimeve krahasuar me 31.8 përqind në qershor 2013, arritën vlerën 137.0 milionë euro që paraqet rënie prej 29.7 përqind. Zvogëlimi i investimeve kapitale i adresohet përfundimit të projektit të autostradës R-7, e cila në gjysmën e parë të vitit të kaluar ka qenë në implementim e sipër. Në rënie të investimeve kapitale kontribuoi edhe ekzekutimi i buxhetit për investime në vetëm 25.1 përqind krahasuar me 30.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 34.0 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 233.0 milionë euro, që është kryesisht rezultat i vendimit të qeverisë për ngritje të pagave. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rritje për 2.8 përqind dhe kanë shënuar vlerën 91.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 4.2 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 164.0 milionë euro.

Sistemi Financiar

Në TM2 2014, vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.3 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.2 përqind. Kjo rritje i atribuohet rritjes së aseteve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale, sektorë këta që dominojnë asetet e sistemit financiar dhe u karakterizuan me rritje të aktivitetit. Sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, gjatë TM2 2014 kishin kontribut më të vogël në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit. Ndërsa, ndihmësit financiar shënuan rënie të aseteve gjatë TM2 2014, duke ndikuar negativisht në rritjen e gjithsej sistemit (figura 12).

Figura 12. Asetet e sistemi financiar të Kosovës, në përqindje (TM2 - 2014)



Burimi: BQK (2014)


Sektori Bankar

Numri i bankave komerciale të licencuara për të operuar në Kosovë, në TM2 2014, arriti në dhjetë pas licencimit edhe të një banke me kapital të huaj. Rrjedhimisht, numri i bankave me pronësi të huaj në Kosovë arriti në tetë, ndërsa asetet e tyre përfaqësojnë 90.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar.

Asetet

Sektori bankar vijoi zgjerimin e aktiviteteve të tij edhe gjatë TM2 2014. Vlera e gjithsej aseteve në TM2 2014 arriti në 3.06 miliard euro, rritje vjetore prej 9.8 përqind (figura 13). Rrjedhimisht, bankat përshpejtuan ritmin e rritjes së aktivitetit të tyre, duke ndërprerë kështu trendin e ngadalësuar të rritjes së aseteve që kishte karakterizuar këtë sektor që nga TM2 2009.

Figura 13. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore



Burimi: BQK (2014)


Kjo rritje i atribuohet kryesisht investimeve në letrat me vlerë, pasuar nga aktiviteti kreditues dhe bilanci me bankat komerciale. Investimet në letrat me vlerë në TM2 2014 u karakterizuan me një rritje vjetore prej 64.5 përqind, ndërsa struktura e portfolios së tyre

mbeti e njëjtë me periudhat e kaluara, ku pjesa më e madhe është investuar në fletëobligacione të qeverive të huaja. Bilanci me bankat komerciale, që kryesisht paraqet depozitat e mbajtura në bankat jashtë vendit, shënoi rritje vjetore prej 22.0 përqind.

Kreditë

Aktiviteti kreditues gjatë TM2 2014 u karakterizua me ritëm më të përshpejtuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Gjithsej kreditë arritën vlerën në 1.89 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.5 përqind e cila është mjaft më e lartë se rritja prej 2.4 përqind në TM1 2014 dhe rritja prej 2.8 përqind në TM2 2013 (figura 14). Ky përshpejtim i rritjes së kreditimit reflekton rritjen e theksuar të kredive të reja të lëshuara nga bankat gjatë periudhës janar-qershor 2014, të cilat shënuan rritje vjetore prej 39.4 përqind, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kishin shënuar rënie vjetore prej 2.0 përqind.

Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive e kishin kreditë për ndërmarrje, të cilat vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive me një pjesëmarrje prej 67.3 përqind (67.7 përqind në TM2

2013), pasuar nga kreditë për ekonomitë familjare të cilat përfaqësojnë 31.4 përqind të gjithsej kredive (30.8 përqind në TM2 2013). Kreditë tjera, të cilat kryesisht paraqesin kreditë në valutë jo euro dhe ndaj jorezidentëve, të cilat kanë peshë të vogël në gjithsej kreditë (1.4 përqind të gjithsej kredive), gjatë TM2 2014 kishin ndikim neutral në rritjen e gjithsej kredive.

Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive




Në TM2 2014, kreditë për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 2.9 përqind, përderisa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje prej 5.6 përqind që paraqet përshpejtim të trendit të rritjes së këtyre kredive. Përshpejtimi i trendit të rritjes së kredive për ekonomitë familjare, mes tjerash, mund të reflektojë rritjen e pagave për shërbyesit civil gjatë kësaj periudhe, gjë e cila mund të ketë ndikuar në rritjen e kërkesës dhe potencialit kredimarrës nga ky sektor.

Sipas sektorëve ekonomik, struktura e kredive të ndërmarrjeve vazhdon të kryesohet nga kreditë e destinuar për tregti me pjesëmarrje prej 52.2 përqind, pasuar nga prodhimtaria me 12.0 përqind dhe ndërtimtaria me 8.9 përqind. Njëri ndër sektorët

me qasjen më të ulët në gjithsej kreditë për ndërmarrjet vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, me pjesëmarrje prej 3.6 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet.

Kontributin më të theksuar pozitiv në rritjen e gjithsej kredive e kishin kreditë për prodhimtari të cilat shënuan rritje vjetore prej 16.9 përqind krahasur me rënie prej 5.1 përqind të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, pasuar nga kreditë për tregti të cilat u karakterizuan me rritje prej 1 përqind (3.7 përqind në TM2 2013). Ndërsa, ndikimi negativ në rritjen e gjithsej kredive për ndërmarrje kishin kreditë për ndërtimtari të cilat shënuan rënie të theksuar prej 10.3 përqind (-1.2 përqind në TM2 2013), pasuar nga kreditë për bujqësi të cilat u zvogëluan për 5.6 përqind (11.9 përqind në TM2 2013).

Figura 16. Kreditë sipas sektorëve të veçant ekonomik, në përqindje (TM2 - 2014)




Burimi: BQK (2014)

Sipas maturitetit, edhe gjatë TM2 2014 struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, edhe pse vërehet një trend i ngushtimit të lehtë të tyre gjatë viteve të fundit (figura 17). Ky ngushtim i kredive me maturim 'nga 1 deri 5 vite' është i shprehur si të kreditë e ndërmarrjeve ashtu edhe tek

kreditë e ekonomive familjare. Krahasuar me vitin paraprak, kemi zgjerim të lehtë kredive me maturim afatshkurtër dhe atyre afatgjatë.


Figura 17. Struktura e maturimit të kredive



Burimi: BQK (2014)

Zhvillimet e ngjajshme mirëpo me trend më të theksuar, konkretisht ngushtimi i pjesëmarrjes së kredive afatmesme dhe zgjerimi i pjesëmarrjes së atyre afatgjata vërehet edhe në strukturën e kredive të reja.

Figura 18. Struktura e maturimit të kredive të reja



Burimi: BQK (2014)


Sektori bankar ka shënuar rritje të aktivitetit, duke u bazuar kryesisht në rritjen e investimeve në letra me vlerë, zgjerimin e aktivitetit kreditues dhe rritjen e

plasmaneve në bankat komerciale jashtë vendit. Norma e rritjes së kreditimit gjatë kësaj periudhe ishte më e larta në 12 muajt e fundit.

Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar në qershor 2014 arritën vlerën 2.42 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.0 përqind, e cila paraqet normën më të lartë të rritjes në dy vitet e fundit (figura 19).

Figura 19. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2014)

Kontribues kryesor në rritjen e gjithsej depozitave në TM2 2014 ishin depozitat e ekonomive familjare, të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind (8.3 përqind në TM2 2013), duke vazhduar kështu të jenë burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Depozitat e ndërmarrjeve u karakterizuan me rritje vjetore prej 11.9 përqind, dukshëm më të theksuar krahasuar me rënie vjetore prej 7.5 përqind të shënuar në vitin paraprak. Rritje më të theksuar shënuan depozitat tjera, me një normë vjetore të rritjes prej 15.0 përqind (3.3 përqind në TM2 2013).

Strukturën e depozitave në sektorin bankar vazhdojnë ta dominojnë depozitat e ekonomive familjare me pjesëmarrje prej 74.2 përqind në gjithsej depozitat. Kategoria e dytë për nga madhësia e depozitave ishin depozitat e ndërmarrjeve, të cilat përfaqësojnë 20.8 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat tjera kanë peshë më të vogël (5.0 përqind) në gjithsej depozitave, rrjedhimisht, edhe ndikimi i tyre në ndryshimin e gjithsej depozitave ishte i limituar.

Figura 20. Struktura e depozitave në bankat komerciale



Burimi: BQQ (2014)

Normat e Interesit


Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita kanë vijuar trendin rënës të tyre edhe gjatë TM2 2014.³

Në kredi, norma mesatare e interesit u zvogëluar në 10.6 përqind krahasuar me 12.3 përqind në TM2 2013 (figura 21). Trendi rënës është i shprehur si te kreditë për ndërmarrje ashtu edhe te kreditë për ekonomitë familjare.

³ Normat mesatare të interesit për kredi dhe depozita janë të kalkuluara në baza kuartale (mesatare tremujore).

Sa i përket kredive për ndërmarrje, norma mesatare e interesit në TM2 2014 është zvogëluar në 10.8 përqind nga 12.0 përqind sa ishte në TM2 2013. Në


Figura 21. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQQ (2014)

kuadër të kredive për ndërmarrje rënien më të theksuar prej 4.5pp e shënoi norma mesatare e interesit në kreditë jo-investuese ‘deri në 1 vit’, të cilat në TM2 2014 zbritën në 10.7 përqind. Kategoria e dytë me rënien më të theksuar të normës së interesit prej 1.1pp ishte kategoria e kredive investuese ‘deri në 1 vit’ e cila arriti në 11.9 përqind (figura 22).

Figura 22. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQQ (2014)

Norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare në TM2 2014 ka shënuar rënie në 10.5

përqind nga 12.3 përqind sa ishte në TM2 2013. Rënie më e theksuar prej 2.1pp ishte te kreditë hipotekare, e cila arriti në 9.4 përqind në TM2 2014. Me rënie u karakterizua edhe norma mesatare e interesit në kredi konsumuese e cila arriti në 11.0 përqind nga 12.0 përqind sa ishte në TM2 2013 (figura 23).


Figura 23. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind



Burimi: BQK (2014)

Norma mesatare e interesit në depozita në TM2 2014 u zvogëlua në 0.6 përqind nga 3.5 përqind sa ishte në TM2 2013. Në rënien e theksuar kontribuan të gjitha kategoritë e depozitave, si të ndërmarrjeve ashtu edhe të ekonomive familjare. Vlen të ceket që rënia më e theksuar e normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare është shënuar gjatë periudhës mars-qershor 2014 (figura 24).

Figura 24. Normat mesatare të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Ndryshimi ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita është zgjeruar në TM2 2014 si rezultat i rënies më të theksuar të normave të interesit në depozita në TM2 2014 krahasuar me rënien e normave të interesit në kredi. Në TM2 2014, ky dallim u rrit në 10.0 pikë përqindje, krahasuar me 8.8 pikë përqindje në TM2 2013 (figura 21).

Profitabiliteti dhe Performanca

Spektori bankar vazhdoi të përmirësojë performancën financiare duke gjeneruar profit prej 26.9 milionë euro deri në muajin qershor, vlerë kjo që është ndjeshëm më e lartë se profiti i gjeneruar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar (15.2 milionë euro deri në qershor 2013). Në rritjen e profitit kontributin kryesor e kishte rënia e theksuar e shpenzimeve krahas rënies së lehtë të të hyrave.


Gjithsej shpenzimet deri në qershor 2014 u karakterizuan me rënie prej 12.6 përqind. Në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve kryesisht ndikuan shpenzimet e jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 32.0 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, rënien më të madhe e shënuan

shpenzimet për provizione, të cilat u reduktuan për 43.8 përqind në krahasim me vitin paraprak. Shpenzimet e interesit deri në qershor 2014 shënuan rënie vjetore prej 19.2 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita ishin kontribuuesi kryesor duke shënuar rënie prej 25.1 përqind. Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, u karakterizuan me rënien më të ulët.

Deri në qershor 2014, sektori bankar u karakterizua me rënie vjetore të të hyrave prej 1.6 përqind. Rënia e të hyrave ishte kryesisht rezultat i rënies prej 2.0 përqind të të hyrave nga interesi. Rrjedhimisht, rënia e normave të interesit për kredi paraqet faktor me ndikim të rëndësishëm në rënien e gjithsej të hyrave të sektorit bankar. Ndërsa, kategoria e të hyrave nga jo-interesi, ku përfshihen të hyrat nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje vjetore prej 2.5 përqind deri në qershor 2014. Rritja e çmimeve për shërbime të caktuara bankare, si dhe zgjerimi i përdorimit të shërbimeve bankare, mund të ketë ndikuar në rritjen e të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

Si rrjedhojë e zhvillimeve të mësipërme, edhe indikator i efikasitetit, që matë raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit u përmirësua dukshëm duke arritur në 77.9 përqind krahasuar 87.7 përqind në qershor 2013 (figura 25).

Figura 25. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale




Burimi: BQK (2014)

Gjithashtu, rritja e theksuar e profitit është reflektuar edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 1.8 përqind, nga 0.9 përqind sa ishte në 2013, kurse ROAE u përmirësua në 19 përqind, nga 9.4 përqind në 2013 (figura 26)⁴.

Rënia e theksuar shpenzimeve që reflekton kryesisht rënien e normës së interesit në depozita, krahas rënies së të hyrave që është kryesisht pasojë e rënies së interesit në kredi, ka rezultuar me gjenerimin e një profiti dukshëm më të lartë në krahasim me vitin paraprak.

⁴ ROAA dhe ROAE janë të analizuar me performancën e sektorit bankar deri në qershor 2014


Figura 26. Treguesit e profitabilitetit



Për 2014 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën gjatë TM2 2014
Burimi: BQK (2014)

Në qershor 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë ka arritur në 8.2 përqind krahasuar me 7.8 përqind sa ishte në qershor 2013 (figura 27). Pavarësisht rritjes, trendi i kredive jo performuese është në rënie duke marrë parasysh që norma e rritjes vjetore të vlerës së kredive jo performuese ishte 11.0 përqind në qershor 2014, krahasuar me 21.2 përqind në qershor 2013. Gjithashtu, vërehet se norma e kredive jo performuese në muajin qershor ka shënuar rënie krahasuar me muajt e parë të vitit 2014 (figura 27).

Figura 27. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë




Burimi: BQK (2014)

Kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme

nga kreditë. Në qershor 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 116.4 përqind (113.2 përqind në TM2 2013).

Figura 28. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Sektori bankar ka përforsuar edhe më shumë nivelin e kapitalizimit, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 17.4 përqind në qershor 2014 nga 15.0 përqind sa ishte në qershor 2013. Përforsimi i atribuohet kryesisht përmirësimit të performancës së sektorit bankar në saje të rritjes së profitit si dhe rritjes së kapitalit nga aksionarët si rezultat i kërkesave të reja të BQK-së.

Niveli i lartë i likuiditetit vazhdon të mbetet karakteristikë e sektorit bankar në vend duke marrë parasysh që në qershor 2014 raporti i kredive ndaj depozitave arriti në 78.1 përqind nga 82.9 përqind në qershor 2013. Për më tepër, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, i cili në qershor 2014 qëndroi në 43.7 përqind, sugjeron nivel të lartë të likuiditetit krahas kërkesave rregullative të BQK-së.⁵

⁵ Me rregullore të BQK-së kërkohet që niveli minimal i raportit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të jetë 25 përqind.

Fondet pensionale

Asetet e sektorit pensional në qershor 2014 arritën vlerën prej 1.0 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24 përqind. Struktura e aseteve të sektorit të pensioneve dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) i cili menaxhon 99.4 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa pjesa e mbetur prej 0.6 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno–Kosovar i Pensioneve (FSKP).

FKPK edhe gjatë TM2 2014 ka vazhduar me performancë pozitive, duke shënuar rritje të aseteve dhe kthimit nga investimet. Gjithsej asetet e FKPK-së në qershor 2014 arritën vlerën prej 996.9 milionë euro. Gjysma e parë e vitit 2014 për FKPK-n është mbyllur me 32 milionë euro kthim bruto prej investimeve. Në ditën e fundit të qershorit 2014, çmimi i aksionit arriti në 1.25 euro (1.14 euro në TM2 2013).

FSKP gjithashtu ka treguar performancë pozitive duke marrë parasysh që vazhdon të ndjekë trend pozitiv të rritjes së aseteve. Në qershor 2014, gjithsej asetet e FSKP-së kishin vlerën 5.6 milionë euro krahasuar me 5.1 milionë euro sa ishin në qershor 2013. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që arriti në 18.6 mijë euro. Në ditën e fundit të qershorit 2014, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 143.84 Euro.⁶

Kompanitë e sigurimit

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në qershor 2014 shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind, duke

arritur vlerën 135.6 milionë euro. Në kuadër të gjithsej aseteve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 121.9 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 13.7 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 40.3 milionë euro, që krahasuar me qershor 2013, paraqet një rënie të lehtë prej 0.5 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 39.0 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë kanë gjeneruar 1.3 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara arriti në 17.1 milionë euro (21.2 milion në qershor 2013), prej të cilave 9.7 milionë janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Deri në qershor 2014, sektori i sigurimeve regjistroi fitim në vlerë prej 113.2 mijë euro, që tregon për një përmirësim të theksuar krahasuar me vitin paraprak ku u shënuar humbje prej 1.4 milionë euro. Përmirësimi i performancës u evidentua edhe në sigurimet jetë edhe në ato jo jetë. Sigurimi jo-jetë zvogëloi humbjet në 316.0 mijë euro deri në qershor 2014, krahasuar me humbjen prej 1.8 milionë euro në vitin paraprak. Ndërsa, sigurimi jetë u karakterizua me rritje të mëtutjeshme të profitit në 429.2 mijë euro nga 323.5 mijë euro fitim në qershor 2013.


Institucionet mikrofinanciare

Institucionet mikrofinanciare ndërprejnë trendin negativ të tkurrjes së aktiviteteve të tyre të ndjekur gjatë viteve të fundit, duke shënuar rritje të aktivitetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2014. Gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar në qershor 2014

⁶ Vlera bazë e aksionit të FSKP-se është 100 për dallim nga ajo e FKPK-se që është 1.

arritën vlerën në 113.1 milionë euro, rritje vjetore prej 0.2 përqind(-6.1 përqind në qershor 2013).

Figura 29. Asetet e institucioneve mikrofinanciare



Burimi: BQK (2014)

Rritja e aseteve gjatë kësaj periudhe u realizua kryesisht përmes zgjerimit të aktivitetit kreditues. Në qershor 2014, gjithsej kreditë shënuan rritje vjetore prej 2 përqind, krahasuar me rënien prej 10.1 përqind në qershor 2013. Në kuadër të gjithsej kredive, kreditë ndaj bizneseve shënuan rritje vjetore më të theksuar prej 3.6 përqind, duke nxitur edhe rritjen e gjithsej kredive, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje prej 1.2 përqind. Lizingjet u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.3 përqind që është dukshëm më e ngadalshme se rritja e shënuar në vitin paraprak (8.4 përqind në qershor 2013). Në kuadër të lizingjeve, rritje shënuan lizingjet për ekonomitë familjare, të cilat u rritën për 39.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në anën tjetër, lizingjet për biznese u karakterizuan me rënie vjetore prej 7.3 përqind.

Spektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me norma më të larta të interesit në kredi në krahasim me sektorin bankar. Mesatarja e normës efektive të interesit për kreditë e lëshuara nga institucionet

mikrofinanciare në TM2 2014 ishte 24.0 përqind (23.1 përqind në TM2 2013).

Niveli i ulët i kredive jo performuese dhe niveli i kënaqshëm i mbulueshmërisë së tyre me provizione vazhdojnë të reflektojnë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë së këtij sektori. Në qershor 2014, niveli i kredive jo performuese në gjithsej kreditë qëndroi në 5.9 përqind (5.3 përqind në qershor 2013), kurse mbulueshmëria e tyre me provizione ishte 106.9 përqind (115.2 përqind në qershor 2013).

Deri në qershor 2014, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra prej 9.3 milionë euro, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rënie prej 4.8 përqind (3.5 përqind deri në qershor 2013). Sidoqoftë, shpenzimet shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 10.2 përqind kryesisht si rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin dhe administratën. Rrjedhimisht, sektori mikrofinanciar deri në qershor 2014 gjeneroi profit prej 13.6 mijë euro krahasuar me humbjen prej 572.5 mijë euro në qershor 2013. Përmirësimi i performancës financiare u pasqyrua në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 0.02 përqind nga (-0.3) përqind sa ishte në dhjetor 2013, ndërsa ROAE u përmirësua në 0.1 përqind nga (-1.1) përqind sa ishte në dhjetor 2013⁷.

Gjatë TM2 2014, sektori pensinal vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare. Rritje e aktivitetit dhe përmirësim i performancës u evidentua edhe në sektorin e sigurimeve. Poashtu, sektori i institucioneve


⁷ ROAA dhe ROAE për vitin 2014 janë të aktualizuara me performancën e sektorit deri në qershor 2014

financiare, pas një periudhe të zvogëlimit të aktivitetit, gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të kreditimit, përderisa masat për zvogëlimin e shpenzimeve përmirësuan profitabilitetin.

Tregu i Bonove të Thesarit

Në periudhën janar-qershor 2014, qeveria e Kosovës ka plotësuar nevojat për financim duke zgjeruar vëllimin e emetimit të letrave me vlerë në 217.6 milionë euro.

Figura 30. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumën e ofertuar për 91 ditë.
Burimi: BQK (2014)

Deri në qershor 2014, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka pasur gjithsej 11 ankande. Prej tyre, 2 me afat maturimi 91 ditë, 4 me afat maturimi 182 ditë, 3 me afat maturimi 364 ditë, si dhe 2 ankande me afat maturimi dy vjeçar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kemi një zhvendosje të emetimit të letrave me vlerë afatshkurtra në drejtim të atyre afatgjata.


Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit deri në qershor 2014 ishte 1.6 herë më e lartë se ajo e kërkuar nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Tejkalimi i vazhdueshëm i ofertave nga akterët primar kundrejt kërkesës së thesarit ka ndikuar në

uljen e normave të interesit në letrat me vlerë. Kjo rënie ishte më e theksuar në fletëobligacionet qeveritare me maturim 1 vjeçar, që u ndikua edhe nga kërkesa më lartë e tyre deri në TM2 2014. Normat më të larta të interesit u hasën tek fletëobligacionet qeveritare me afat maturimi dy vjeçar (2.5 përqind), pasuar nga ato me maturim një vjeçar (1.3 përqind). Ndërsa, fletëobligacionet qeveritare me maturim 182 ditë dhe ato me maturim prej 91 ditë kishin norma të interesit prej 1 përkatësisht 0.5 përqind.

Sektori i Jashtëm

Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë është përkeqësuar në TM1 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Deficiti i llogarisë rrjedhëse ka shënuar vlerën prej 36.8 milionë euro në TM1 2014, krahasuar me 13.4 milion euro sa ishte në TM1 2013. Ky përkeqësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse ka ardhur si rezultat i nivelit më të ulët të të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse të cilat shënuan rënie për 23.6 përkatësisht 5.4 përqind.

Figura 31. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2014)

Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 1.0 miliard euro deri në qershor 2014, që paraqet një rritje prej 1.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 31). Gjithsej eksportet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 arritën vlerën 141.0 milion euro, që përkon me një rënie vjetore prej 5.2 përqind. Zvogëlimi i eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së vlerës së eksporteve të metaleve bazë, si kategori me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të vendit, gjë e cila ndodhi kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të metaleve bazë në tregjet ndërkombëtare. Me rënie të vlerës së eksportuar deri në qershor 2014

u karakterizuan edhe kategoria e produkteve minerale, kategoria e makinerive dhe pajisjeve tjera, lëkurës dhe produkteve të lëkurës, plastikës dhe produkteve të plastikës, etj.

Figura 32. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 arriti në 1.1 miliard euro, që paraqet një rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 0.7 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e pijeve dhe duhanit, makinerive dhe pajisjeve elektrike, produkteve bujqësore, etj. Si pasojë e rënies së vlerës së eksporteve deri në qershor 2014, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u zvogëlua në 12.4 përqind, nga 13.1 përqind sa ishte në qershor 2013.

Një ndër kategoritë më të rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave në Kosovë, e cila vazhdon të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, mbeten remitencat. Në TM1 2014, remitencat arritën vlerën prej 130.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.4 përqind (figura 32).

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Vlera e gjithsej IHD-ve arriti në 39.5 milionë euro në TM1 2014, që paraqet rënie krahasuar me vlerën prej 60.3 milion euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie e IHD-ve mund ti atribuohet kryesisht shpërndarjes së superdividendës⁸ së disa kompanive të huaja që operojnë në Kosovë (figura 33).

Figura 33. Struktur e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

⁸ Me superdividendë nënkuptohet dividenda e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2014): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 7 TM1 2014, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2014):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1.129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1.124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1.163>

ASK (2014):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në qershor 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në qershor 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në qershor 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në qershor 2014: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në qershor 2014: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2014): Metal Prices database, qasur në qershor 2014.

FAO (2014): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në qershor 2014: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2014): Euribor Historical Rates, qasur në qershor 2014:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2014): World Economic Outlook: qasur në qershor 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2013	Qershor 2014
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	2.7%	0.3%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	2.7%	0.4%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	604.6	603.0
Shpenzimet (në milionë euro)	612.2	625.0
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-0.1	-0.4
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,330.2	5,873.8
prej të cilave: Bankat	2,787.0	3,059.5
Kredi	1,825.7	1,889.9
Depozita	2,201.3	2,421.0
Norma e interesit në kredi	12.0	10.6
Norma e interesit në depozita	3.5	0.6
Hendeku i normës së interesit	8.5	10.0
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	Mars 2013	Mars 2014
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-13.4	-36.8
prej të cilave: remitencat	127.8	130.8
Llogaria financiare	-10.1	-28.8
Investimet e huaj direkte në Kosovë	60.3	34.3
Investimet portfolio, net	-53.5	-50.2
Investimet tjera, net	-20.1	-19.0
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	416.8	434.2
Asetet	3,857.2	4,149.7
Detyrimet	3,440.4	3,715.5
Borgji i jashtëm, gjithsej	1,452.9	1,581.5
Borgji i jashtëm privat	1,054.9	1,201.9
Borgji i jashtëm publik	398.0	379.6

Burimi:

1/ ASK (2014).

2/ MF (2014).

3/ BQK (2014).

